

V E N D I M
Nr.213, datë 2.8.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZONËS ZGJEDHORE NR.4

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, asistuar nga sekretarja Merita Dulaku në mbledhjen e tij të datës 2.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Igli Toska	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Shpalljen e rezultatit përfundimtar të zonës zgjedhore nr.4.
Baza Ligjore: Neni 18, pika 1 dhe pika 4, të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 "Për kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

KONSTATOI SE:

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga ana e kandidatit për deputet në zonën njëemërore nr.4 z.Ndrek Rukaj, është paraqitur tërheqja nga kandidimi, me pretendimin se gara është e pandershme dhe se është cënuar personaliteti i tij si kandidat.

Z.Ndrek Rukaj, në renditjen e kandidatëve, sipas votave të fituara në këtë zonë zgjedhore, renditet e dyti pas kandidatit Valentin Palaj. Pas largimit të z.Rukaj nga kandidimi, diferenca ndërmjet kandidatit Valentin Palaj dhe kandidatëve të tjerë është shumë e madhe dhe nuk ndikon në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se pas tërheqjes nga kandidimi për deputet të z.Ndrek Rukaj mund të shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 18 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë"

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.4, duke njohur si fitues kandidatin për deputet z.Valentin Palaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZëvendëskryetariKryetari
Gasper Kokaj Ilirjan Celibashi